



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 272, Datë 31.10.2025

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, dhe nenit 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2478/5 prot., datë 27.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GSA Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2478 prot., datë 18.09.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 242, datë 30.09.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.10.2025 dhe 02.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 2478/3 prot., datë 03.10.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2478/4 prot., datë 10.10.2025, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin,

njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar.

- Nga përmbajtja e vendimit të organeve drejtuese të shoqërisë “GSA Energy” sh.p.k., rezulton se angazhimi për vendosjen në dispozicion të stafit teknik dhe mjeteve financiare për ushtrimin e veprimtarisë është marrë nga shoqëria mëmë. Si e tillë vlerësohet që, në kuadër të raportimeve përkatëse, t’i lihet detyrë shoqërisë të depozitojë në ERE vendimin e korigjuar, ku të shprehet angazhimi përkatës.
- Shoqëria i disponon aktualisht zyrat përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i kontratës së qirasë përfundon më 01.06.2030 dhe nuk mbulon afatin 5-vjeçar të licencës, vlerësohet t’i lihet kusht shoqërisë që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “GSA Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Brenda datës 01.06.2030, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të pikës 2.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GSA Energy” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrît AHMETI